

**STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"AMERICAN AUTO GARAGE" Sh.P.K**

Sipas ligjit Nr.° 9901 Date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", dhe ne perputhje me Ligjet qe operojne ne Republiken e Shqiperise,

**Blendi Sukaj**, shtetas Shqiptar lindur ne Kavaje me 25.03.1981, identifikuar me pasaport nr I10325153B, madhor dhe me pergjegjesi te plote per te vepruar.

Sot me 08/06/2020 vendosin te themelojne Shoqerine " **AMERICAN AUTO GARAGE**" Sh.P.K.

***Neni 1***

***Emertimi i shoqerise***

Shoqeria do te mbaje emrin "AMERICAN AUTO GARAGE " Sh.P.K. Emertimi tregetar do te jete " AMERICAN AUTO GARAGE"

***Neni 2***

***Forma Ligjore e Shoqerise***

Shoqeria do te kete formen e saj Ligjore, "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" sipas Ligjit Nr. 9901 Date 14.14.2008 "Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" bashke me ndryshimet perkatese. Shoqeria mund te ndryshoje formen e saj ligjore me vendim te ortakeve themelues.

***Neni 3***

***Afati***

Veprimtaria e kompanisë do të fillojë në datën e regjistrimit të saj prane Qendres Kombetare te Biznesit. Aktiviteti i shoqërisë do të jete pa afat.

***Neni 4***

***Selia***

Shoqeria do te kete seline e saj ne adresen: Kashar, Lagjja Yzberisht, Rruga "Butrinti", Km 6, Godinë 1 Katëshe Nr.19

Shoqeria mund te kryeje e te transferoje, apo te menaxhoje qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit, me vendim te ortakeve themelues. Shoqeria ofron mundesine e pjesmarrjes ne shoqeri te tjera ne te ardhmen te cilat do te krijojne aktivitete ne Republiken e Shqiperise dhe/ose jashte saj, me vendim te asamblese se ortakeve themelues.

***Neni 5***

***Objekti***

Shoqeria ka per objekt veprimtarite e meposhtme:

- Servis per automjete dhe lavazh

- Servis per riparime elektrike, mekanike, pjese kembimi, etj te automjeteve te te gjitha llojeve.
- Import-Export
- *Te drejta per te kaluar emrin tregtar paleve te tjera*

Për të arritur qellimin e shoqërisë dhe pa e zgjeruar atë, mund të kryejë të gjitha veprimet për investimin në fushën e servisit, Import -Export të pjesëve të këmbimit dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm, objekti i të cilave është i ngjashëm ose i njëjtë.

### ***Neni 6 Kapitali***

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100.000 (njqind mije) Leke i përbërë si vijon:  
**Blendi Sukaj** zotëruar i një kuote të barabartë me 100% të kapitalit themelues të shoqërisë, ekuivalente në vlerë nominale me 100.000 leke.

### ***Neni 7 Organet Drejtuese dhe vendimarrëse***

Organi vendimarrës i shoqërisë është asambleja e ortakëve themelues të shoqërisë, e cila drejton aktivitetin e shoqërisë nëpërmjet vendimeve të tij.

- a. përkufizimi i politikave të kompanisë
- b. ndryshon dhe/ose modifikon statutin e shoqërisë
- c. emeron dhe shkarkon administratoret
- d. emeron dhe shkarkon auditoret
- f. përcakton nxitjen e personave në paragrafin C dhe D.
- e. ndryshon seline
- f. ndryshon emrin e shoqërisë
- g. rikapitalizon shoqërinë, duke rritur dhe/ose zvogëluar shoqërinë
- k. ndarjen ose anulimin e kuotes
- h. riorganizimin ose prishjen e shoqërisë
- i. miraton rregulloren procedurale për mbledhjen e mbledhjes të ortakëve të shoqërisë.
- j. të tjera të parashikuara nga ligji ose statuti

Asambleja e përgjithshme mbledhet me kërkesën e secilit prej ortakëve.

Në rastet e mbledhjeve të tjera jo të zakonshme, rritje apo zvogëlim kapitali, ndryshim administratori, shpërndarje dividendi apo shpërndarje –likuidim i shoqërisë, ortakët do të përfaqësojnë vetveten për të shprehur vullnetin e tyre.

### ***Neni 8 Administrimi***

Administrimi i shoqërisë është besuar një administratori të vetëm.

-Administratori duhet të raportojë çdo muaj për asamblyen situatën ekonomiko-financiare dhe rezultatin financiar të muajit.

-Administratori duhet të miratojë politikën e çmimeve dhe zbritjeve përkatëse pranë Asamblesë.

-Administratori duhet të miratojë pranë asamblesë blerjet për investime dhe çdo blerje tjetër jashtë shpenzimeve të përmuajshme administrative të administrimit të zakonshëm

- Administratori menaxhon punën e përditshme të shoqërisë dhe është përgjegjës për aktivitet e mëposhtme:
- Ekzekutimi i operacioneve të përditshme të shoqërisë,
- Përfaqësuesi i shoqërisë kundrejt palëve të treta, saktësisht ose me zëvendësim të caktuar me prokurë,
- Hartimi dhe mbajtja e pasqyrave financiare, propozimi i auditorëve, nëse është e nevojshme,
- Përgatitja e dokumentave në emër të shoqërisë,
- Përgatitja e kontratave të punësimit dhe zgjidhja e tyre sipas çdo çështje,
- Aktivitete të tjera të çdo lloji në dobi të shoqërisë dhe realizimit të objektit të saj.
- Shoqëria do te kete vulen e saj tr miratuiar nga ortaket.

Shoqëria do te kete administratorin e saj te vetem, **Z. Blendi Sukaj**, shtetas Shqiptar lindur ne Kavaje me 25.03.1981, identifikuar me pasaport nr I10325153B, madhor dhe me pergjegjesi te plote per te vepruar, per 5 vjet me te drejte rinovimi.

Me vendim te asamblese se aksionereve Administratori mund te ndryshohet para afatit te percaktuar me siper .

#### ***Neni 9***

##### ***Ushtrimi Financiar***

Viti financiar i shoqërisë eshte nga 1 Janari dhe mbaron më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë i veprimtarisë së shoqërisë do te llogaritet nga data e regjistrimit të shoqërisë dhe do përfundoje më 31 Dhjetor.

#### ***Neni 10***

##### ***Të ardhurat, Dividentët***

Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e aktivitetit te shoqerise. Fitimi pas përfundimit të vitit financiar dhe pas pagimit të tatimit, mund të shpërndahet tek ortaket me vendim te asamblese se ortakeve themelues te shoqerise.

***Neni 11***

***Shpërndarja dhe Likuidimi***

Shpërndarja e shoqërisë mund të bëhet për sa vijon:

- a. Fundi i kohëzgjatjes së aktivitetit të parashikuar në aktin e themelimit;
- b. Me vendimin e asamblese se ortakëve themelues të shoqërisë;
- c. Hapja e një procedure falimentimi;
- d. Nëse nuk kryen aktivitete tregtare për dy vite të vazhdueshme dhe pse nuk është kërkuar pezullimi i shoqërisë në QKB;
- e. Me vendimin e gjyqtarit;

Likuiduesi, raporton për statusin e aktiveve dhe detyrimeve të kompanisë në operacionet e mëtejshme të shlyerjes dhe kohën e nevojshme për mbylljen e procesit. Në fund të këtij procesi, ortakët, do të informohet për balancën përfundimtare dhe mbylljen e procedurës së likuidimit.

***Neni 12***

***Klauzola mbyllëse***

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë, nëse nuk zgjidhen në mënyrë miqësore, palët drejtohen organeve kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, përveç rasteve kur kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas ligjit është Sistemi Gjyqësor Shqiptar.

(Emer Mbiemer / Nenshkrimi)

ORTAKET E SHOQERISE

**Blendi Sukaj**

Blendi Sukaj

---